



2-0 / DPKI

02

01-585/2012

15.02.2012



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.02.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. **AKK-03-3843/11**, për z.Blerim Limani, Këshilltarë komunalë në Kuvendin Komunal në Lipjanë, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit më numër protokolli AKK-03-3843/11, lidhur me zyrtarin z.Blerim Limani këshilltarë komunalë në Kuvendin Komunal në Lipjanë, janë zhvilluar të gjitha procedurat për të vërtetuar gjendjën e konfliktit të interesit në kohën kur kompania “N.SH.Higjena” e cila është pronë e vllaut të tij ka qenë përfituese e tenderit përmirësuar “Mimbajtje dhe sigurim të objekteve të Komunës së Lipjanit”.

Pas analizmit të dokumentacionit dhe procesit është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë gjendjën e konfliktit të interesit, pasi qe z.Blerim Limani këshilltarë komunalë në K.K.Lipjanë nga pozita e tij nuk ka mundur dhe nuk qenë në pozitë vendimarrëse përmirësuar për këtë tenderë, pasi qe pozita e tij si këshilltarë komunalë nuk ka asnjë lidhëshmeri me Departamentin e Prokurimit, dhe me procesin ne pergjithësi.

Përfitimi i këtj tenderi nga kjo kompani që nuk është pronësi të z. Blerim Limani nuk parqet konflikt të interesit te paraparë si pasë ligjit Nr.04/L-051, për Prandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Konsiderojmë se nuk ka elemente që deshmojnë gjendjën e konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

